

KONTRATA dhe STATUTI

Për krijimin e shoqërisë Polyurea Coating EU Shpk

§ 1. Firma dhe Selia

- (1) Firma e shoqërisë do të quhet Polyurea Coating EU shkurt PCE shpk
- (2) Ortak i vetëm i shoqërisë është Z. Dariusch Antighetschi.
- (3) Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë Rr. K. Karafili, P. 24 H. 14 Ap.14.
- (4) Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

§ 2. Objekti i ndërmarrjes.

Objekt i ndërmarrjes është përpunimi, riparimi, montimi dhe çdo aktivitet tjeter i ngashëm, i karocerive të automjeteve të të gjitha llojeve, i kontenierve te anijeve si dhe eksport i ketyre produkteve.

§ 3. Kohëzgjatja e Shoqërisë

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë është pa afat.

§ 4. Kapitali Shoqërisë

- (1) Kapitali i shoqërisë është në shumën 100 000 Lek, i përbërë nga një kuotë me vlerë nominale 100 000 Lek, që zotërohet 100% nga ortaku i vetëm
- (2) Shoqëria nuk mund të ofrojë kapitalin si mjete investimi për publikun e gjerë.
- (2) Kuotat e kapitalit të shoqërisë si dhe të drejtat që rrjedhin prej saj, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- (3) Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

§ 5. Drejtimi i shoqërisë dhe përfaqësimi

5.1. Administratori

- (1) Shoqëria ka një ose disa administratorë. Nëse shoqëria ka emëruar vetëm një administrator, ky është përfaqësuesi i vetëm i shoqërisë. Administrator i shoqerise eshte Z. Dariusch Antighetschi.
- (3) Administratori i nënshtronet detyrimit të besnikërisë, heshtjes, informimit dhe bindjes. Gjatë ushtrimit të detyrave ai duhet të marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakut.
- (4) Kohëzgjatja dhe Kompetencat e përfaqësimit caktohen me vendim të Ortakut të vetëm të shoqërisë.
- (5) Me vendim të Ortakut të vetëm të shoqërisë administrimi mundet ti caktohet nëpërmjet një kontrate administrimi edhe një Avokati ose një subjekti të përshtatshëm. Ky vepron si administrator i shoqërisë.

Aplikant: Arben UAMA
[Signature]

- (6) Ortaku i shoqërisë dhe Administratori nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë e parë.

5.2. Asambleja Përgjithshme

- (1) Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë në çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorit dhe kompetencat e tij;
 - ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimit për administratorin dhe personat e përmendur në shkronjat "ç" të kësaj pike;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- (2) Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme për shoqërinë **Polyurea Coating EU** ushtrohen nga ortaku i vetëm.

§ 6. Prishja e shoqërisë

Shoqëria **Polyurea Coating EU shpk** prishet:

- a) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- c) për arsyet e tjerë, të parashikuara në ligj.

Ortaku i vetëm i shoqërisë

(Dariusch Antighetschi)

D. Antighetschi
Hahnstraße

03/09/2021

Aptikort: Agnon UMAZ
F. [Signature]